



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 498 / Prot
2

Tiranë, më 17 / 4 / 2019

VENDIM

Nr. 07, datë 17 . 4 . 2019

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi Qendra “Birn Albania”, përfaqësuar nga znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 498 Prot., datë 28.03.2019, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Sarandë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Nëpërmjet kërkesës së datës 18.02.2019, znj. _____ ka kërkuar ti vihet në dispozicion dokumentacioni për projektet e financuara nga Fondi i Rajoneve, si më poshtë:

1. *Pyllëzimi dhe gjelbërimi i kurorës së qytetit,*
2. *Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare, Gjashtë,*
3. *Ndërtimi i kopshtit në zonën e sipërme urbane,*
4. *Ndërtim asfaltim rr. nr. 5, Loti 2 dhe 3,*
5. *Rikonstruksion i Rrugës së Fermerëve,*
6. *Ndërtimi i një shkolle të re 9- vjeçare,*
7. *Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit,*
8. *Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza zona Hotel “Butrinti” deri te Kanali Çukës,*
9. *EKO Kampus Saranda,*
10. *Varrezat monumentale të shqiptarëve të Çamërisë në Klllogjer,*

11. Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e flamurit.

Gjithashtu ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni dhe dokumentacioni, i mëposhtëm:

- *Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë projektuese.*
- *Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë zbatuese.*
- *Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë supervizuese.*
- *Kompani nënkontraktuese për zbatimin e projektit.*
- *Cili është statusi aktual i projektit, tenderuar, në ndërtim, përfunduar.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 498 Prot., datë 28.03.2019 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr. 498/1 Prot, datë 29.03.2019, i ka kërkuar Autoritetit Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni. Në vijim, me emailin datë 05.04.2019, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke vendosur në dispozicion dokumentacionin në lidhje me objektin "Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e flamurit" dhe ka sqaruar se informacioni i kërkuar në pikën 10 të kërkesës, "Varrezat monumentale të shqiptarëve të Çamërisë në Kllloqer" disponohet nga Bashkia Konispol.

Ankuesi, me anë të emailit datë 05.04.2019, kërkon vendosjen në dispozicion të 9 projekteve të tjera të kërkuara së bashku me dokumentet shoqëruese. Në mungesë të një përgjigje të plotë nga Autoriteti Publik, ankuesi ka vijuar me ankimin e datës 16.04.2019.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri, vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit "*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*".

Ligji për të Drejtën e Informimit ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Njësitë e qeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". Konkretisht neni Neni 15 "Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore", në të cilin parashikohet se: "*1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.*

2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike..." Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Përsa më sipër, konstatohet se, Autoriteti Publik ka trajtuar pjesërisht kërkesën për informim, duke refuzuar në këtë mënyrë të drejtën për t'u informuar sipas objektit të kërkesës. Kërkesit i është vendosur në dispozicion vetëm kopje e dokumentacionit për objektin "Rikonceptim dhe rivitalizim i qendrës, së qytetit Sarandë, Rruga e flamurit". Megjithëse ka kaluar afati për kthimin e përgjigjes, rezulton se nuk i është dhënë informacioni për 9 projektet e tjera të kërkuara.

Për sa i përket pikës 10 të kërkesës, "Varrezat monumentale të shqiptarëve të Çamërisë në Klllogjer", Autoriteti Publik bën me dije kërkesin se ky informacion disponohet nga Bashkia Konispol dhe nuk ka deleguar kërkesën pranë autoritetit kompetent, në kundërshtim kjo me pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili parashikon se: *"Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkesin..."*.

Komisioneri vlerëson se, ekzistenca e dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, ngarkon me përgjegjësi Autoritetin Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Birn Albania" ndaj Bashkisë Sarandë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative' i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 498 Prot., datë 28.03.2019 të Qendrës "Birn Albania", përfaqësuar nga znj. _____, kundër Autoritetit Publik "Bashkia Sarandë", me objekt *"Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare"*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar për projektet e financuara nga Fondi i Rajoneve, si më poshtë:
 - 2.1. *Pyllëzimi dhe gjelbërimi i kurorës së qytetit;*
 - 2.2. *Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare, Gjashtë;*
 - 2.3. *Ndërtimi i kopshtit në zonën e sipërme urbane;*

- 2.4.Ndërtim asfaltim rr. nr. 5, Loti 2 dhe 3;
2.5.Rikonstrukcion i Rrugës së Fermerëve;
2.6.Ndërtimi i një shkolle të re 9- vjeçare;
2.7.Zëvendësimi i tubacionit të ujësjellësit nga stacioni i pompimit Vrion deri në rezervuarin e qytetit;
2.8.Përmirësimi i rrjetit të ujërave të zeza zona Hotel "Butrinti" deri te Kanali Çukës;
2.9.EKO Kampus Saranda,

konkretisht:

- Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë projektuese.
 - Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë zbatuese.
 - Kopje të kontratës së lidhur me kompaninë supervizuese.
 - Kompani nënkontraktuese për zbatimin e projektit.
 - Cili është statusi aktual i projektit, tenderuar, në ndërtim, përfunduar, brenda datës 26. 4 .2019.
3. Urdhërimin e Autoritetit Publik për delegimin e kërkesës për informacion, në lidhje me pikën 10 të kërkesës "Varrezat monumentale të shqiptarëve të Çamërisë në Kllogjer" pranë Bashkisë Konispol.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Ky vendim u shpall sot në datë 17. 4 .2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

